



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 2395 Prot

Pogradec, më 17.06.2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZNJ. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur, po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues “Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar të bashkisë Pogradec”.

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ Prot

Pogradec, më ____ . ____ .2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____, datë ____ . ____ .2025

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË
BASHKISË POGRADEC"**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Qendrës Arsimore, Bashkia Pogradec, me propozim të kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Të miratojë planin e arsimit parauniversitar të bashkisë Pogradec, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi në shumën 30,157,208.61 (tridhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetë pikë gjashtëdhjetë e një) lekë për rikonstrukcionin e kopshtit Liri Çomo dhe ndërtimin e godinës së çerdhes si dhe 70,156,980.43 (shtatëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë pikë dyzet e tre) lekë për rikonstrukcionin e shkollës "Kajo Karafili", do të përballohen nga fondi i MAS dhe buxheti i Bashkisë Pogradec.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Qendrës Arsimore dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar, Bashkia Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KRYETARI

Nr. 2345 Prot

Pogradec, më 17.06.2025

RELACION

Në lidhje me Projekt -Vendimin "Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar të bashkisë Pogradec",

E nderuar Kryetare e Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë !

Bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma "b", nenin 23 pika 12, neni 24 pika 1, nenin 54 gërma "k", neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar propozojmë të miratohet nga Këshilli Bashkiak, "Plani i arsimit parauniversitar" në Bashkinë Pogradec.

Qëllimi i këtij plani është të vijoje të shërbejë si një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që synon një zhvillim të qendrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit, i cili konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Pogradec.

Plani që propozojmë, do të vijoje të luajë një rol të rëndësishëm për Bashkinë Pogradec, drejt rritjes së cilësisë së shërbimit të arsimit dhe konsolidimit të standardeve të tij.

Procesi i hartimit të Planit të arsimit parauniversitar në Bashkinë Pogradec (në vijim referuar si Plani) është mbështetur nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financës.

Qëllimi i këtij plani është të përmirësojë cilësinë e arsimit në Bashkinë Pogradec, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së IA, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parauniversitar. Plani synon të harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët dhe koherent, duke përfshirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin dhe gjetjen e zgjidhjeve efektive dhe inovative për një arsimim gjithëpërfshirës dhe të standardizuar.

Dokumenti gjithashtu përfshin një analizë përmbajtësore e cila përfshin Vizionin, Misionin, dhe Objektivat Strategjike të Planit, duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij.

Pjesa e dytë e dokumentit fokusohet në vendosjen e objektivave specifike për secilin proces, ndërkohë që në pjesën e tretë, paraqitet buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren për rritjen e cilësisë së arsimit parauniversitar.

Plani ka edhe një aneks dedikuar treguesve të performancës për t'u përdorur për monitorimin e tij në vitet që vijnë.

Plani do të shërbejë për të gjitha kopshtet dhe shkollat nën juridiksionin e Bashkisë Pogradec dhe do të monitorohet nga Qendra Arsimore dhe ZVAP Pogradec, me qëllim përmirësimin e shërbimeve arsimore për të gjithë fëmijët dhe nxënësit në këtë bashki.

Plani i arsimit parauniversitar në Bashkinë Pogradec, përqendrohet në proceset e menaxhimit të shërbimit në arsimin, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv. Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve/ nxënësve në IA dhe vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme.

Objektivat kryesore të planit përfshijnë kryesisht rikonstruksione dhe ndërtimin e një godine të re që do të shërbeje si IA me qëllim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies në çerdhe, kopshte dhe shkolla dhe më pas një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe minimizimit të braktisjes shkollore dhe orientimit të nxënësve drejt arsimit profesional. Gjithashtu në fokus është edhe vemendja e shtuar që do tu kushtohet fëmijëve/nxënësve me aftësi ndryshe duke krijuar klase burimore aty ku do të jetë më shumë e nevojshme.

Për një periudhë dy vjeçare, Plani prezanton sfidat dhe mundësitë specifike, duke përfshirë nevojën për të identifikuar nevojat e komunitetit dhe për të përdorur teknologjinë për të përmirësuar menaxhimin e të dhënave.

Plani synon të adresojë edhe proceset kryesore të përmirësimit të shërbimit për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe ata me aftësi ndryshe në IA publike të Bashkisë Pogradec.

Përmes një planifikimi cilësor, pritët të rritet identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi më i mirë i këtyre rasteve në mënyrë që të sigurohet një shërbim cilësor dhe i plotë për fëmijët në nevojë.

Për të arritur këtë qëllim, plani ka disa objektiva të përgjithshëm, si rritja e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimi i procesit të menaxhimit të këtyre rasteve. Në mënyrë specifike, për të adresuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, plani synon të përmirësojë procesin e diagnostikimit të tyre dhe të sigurojë infrastrukturë të përshtatshme në IA për t'i bërë ata të aksesueshëm.

Përveç kësaj, synohet edhe hartimi dhe zbatimi i politikave të mbrojtjes së fëmijëve në institucionet arsimore dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes strukturave të shërbimit social të përfshira për të garantuar një trajtim të drejtë dhe të efektshëm për të gjithë fëmijët në nevojë.

Planifikimi dhe zbatimi i proceseve mbështetëse në Planin e Arsimit Parauniversitar për institucionet arsimore publike të Bashkisë Pogradec, është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët dhe nxënësit. Këto procese janë themelore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, duke përfshirë trajnimin e stafit, përmirësimin

e infrastrukturës së kopshteve/shkollave dhe sigurimin e materialeve të nevojshme. Qëllimi i proceseve mbështetëse është të ofrojnë mbështetje efektive për proceset kryesore të shërbimit në IA. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë fëmijët dhe nxënësit.

Për të arritur këtë qëllim, objektivat kryesore përfshijnë plotësimin e standardeve të vendosura nga ligji për stafin e IA, rikonstruksionin/mirëmbajtjen periodike të godinave për të përmirësuar infrastrukturën dhe sigurimin e materialeve bazë për të përmbushur nevojat e zhvillimit të nxënësve.

Për rikonstruksionin e godinave, janë identifikuar nevojat konkrete të kopshteve dhe shkollave, duke përfshirë rikonstruksionin dhe /ose rinovimin/mirëmbajtjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme.

Për të realizuar të gjitha projektet e përfshira në Planin e Arsimit Parauniversitar, nevojitet buxheti përkatësisht: 30,157,208.61 (tridhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetë pikë gjashtëdhjetë e një) lekë për rikonstruksionin e kopshtit Liri Çomo dhe ndërtimin e godinës së çerdhes, 70,156,980.43 (shtatëdhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë pikë dyzet e tre) lekë për rikonstruksionin e shkollës "Kajo Karafili" si edhe fonde/ burime njerëzore shtesë për të përmbushur të gjitha objektivat e tjera.

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt-Vendim.

Faleminderit!

Të dhënat e Projekt-Vendimit:

Konceptoi: L. SHKULLAKU

Miratoi: A.ANDONI

Konfirmoi: Irsa KARAPANÇA

Dritan BABASULI

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 8345 Prot

Pogradec, më 17.06.2025

RELACION

MBI PROJEKT-VENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË BASHKISË
POGRADEC”

E nderuar Kryetare e Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë !

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon: **“Akt normativ nënligjor”** është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. “Akti administrativ”:

a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij si dhe me miratimin e tij do të ketë një zhvillim të qendrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e arsimit, i cili konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Pogradec.

Plani do të shërbejë për të gjitha kopshtet dhe shkollat nën juridiksionin e Bashkisë Pogradec dhe do të monitorohet nga Qendra Arsimore dhe ZVAP Pogradec, me qëllim përmirësimin e shërbimeve arsimore për të gjithë fëmijët dhe nxënësit në këtë bashki.

Gjatë zbatimit të tij, ky projekt-vendim shtrin efektet e tij në planin e arsimit parauniversitar në bashkinë Pogradec.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Keshilli Bashkiak Pogradec ne bashkepunim me Ekzekutivin, organizon konsultim publik për ‘Planin e arsimit parauniversitar për bashkinë Pogradec’

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë Z. Ilir Xhakolli

Qëllimi: Ky konsultim me banorët dhe grupet e synuara te Bashkisë Pogradec ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me Planin e arsimit parauniversitar për bashkinë Pogradec.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin/grupet e interesit do të zhvillohet në Bashkinë Pogradec, Salla e Keshillit Bashkiak, sipas informacionit me poshte:

Data _____.____.2025 Ora _____.____ Vendi Salla e keshillit

Gjithashtu, sugjerimet tuaja, te nderuar banore te bashkise Pogradec, janë të mirëpritura, në adresen e e mail:

tollakumatilda507@gmail.com

ledio.shkullaku@gmail.com

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Komisioni i arsimit i KB Pogradec, Perfaqesues te administrates se bashkisë, Drejtoria e Qendrës Arsimore
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Pogradec, në mënyrë të vecantë anëtarë të bordeve dhe këshillave të prindërve, mesuese dhe drejtuese te arsimit parashkollor dhe parauniversitar, perfaqesues nga ZVAP Pogradec, perfaqesues nga Qendra Speciale, perfaqesues nga Drejtoria e sherbimeve sociale ne bashki, Drejtoria e Finances, perfaqesues nga shkolla profesionale

Forma e konsultimit: Takim i drejtperdrejte, sugjerime permes e mailit.

Qëllimi i këshillimit publik	Diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve “ Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar të Bashkisë Pogradec”
Përshkrimi i çështjes	Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të kontribuojë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e Arsimit parauniversitar. Arsimi, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Pogradec. Plan i arsimit parauniversitar synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese te ketij sherbimi, në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjike.Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

	• Përmirësimi i shërbimit në kopshte/shkolla përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës arsimore, me qëllim përsimrësimin e shërbimit dhe ndërhyrjen në IA që kanë nevojë imediate për restaurim; • Zhvillimi i burimeve njerëzore në çështje të arsimit parauniversitar, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit parauniversitar; • Përditësimi i një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të Arsimit Parauniversitar, sipas të cilës të sigurohet respektimi i kërkesave ligjore dhe kuadrit të brendshëm rregullator nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata). • Bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin, për të ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka arsimi në zhvillimin e fëmijës; • Gjetja e zgjidhjeve inovative për të mundësuar shërbim cilësor të arsimit në përgjithësi, si në qytet, ashtu edhe në Njesite Administrative të bashkisë Pogradec.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të specialistit të arsimit në bashki: ledio.shkullaku@gmail.com dhe sekretarise se Keshillit bashkiak tollakumatilda507@gmail.com brenda dates _____.____.2025
Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli dhe administrata për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë dhe Bashkia Pogradec do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë dhe Komisionit Arsimit. 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të Arsimit të cdo rekomandimi dhe opinionit. 4. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 5. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar. 6. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	_____.____.2025